

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “ Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta - Akti i Infrastrukturës Gigabit ”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Transpozim i Rregullores së BE -së
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Rregullorja (BE) 2024/1309 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 29 prill 2024, “Mbi masat për të ulur koston e vendosjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike Gigabit,” që ndryshon Rregulloren (BE) 2015/2120 dhe shfuqizon Direktivën 2014/61/BE (Akti i Infrastrukturës Gigabit), numri CELEX 32024R1309
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	<u>Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022 - 2030</u> Programi Politik i Këshillit të Ministrave 2025-2029
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	16.04.2026 - 14.05.2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	1.06.2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 29.5.2026
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 – MIE – Nr.4
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Altin Sallaku Altin.sallaku@infrastruktura.gov.al ; Irena Malolli irena.malolli@infrastruktura.gov.al ; +35542222245 Anisa Gjonedaj Anisa.gjonedaj@infrastruktura.gov.al ;
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)	
Shqipëria është e angazhuar fort në procesin e integritimit në tregun e vetëm digjital. Agjenda Kombëtare e Reformave 2024 – 2027, e miratuar me VKM nr. 621, datë 10.10.2024, përfshin nën Fushën politike: “3. Digjitale”, përfshin reforma/masa që lidhen me infrastrukturën digjitale/broadband dhe 5G. Masa 3.1.3 e Agjendës së Reformave lidhet me infrastrukturën digjitale dhe kërkon adoptimin e legjislacionit përkatës me atë	

Bashkimit Evropian për Aktin e Infrastrukturës Gigabit që është miratuar me Rregulloren e BE-së 2024/1309/EU.

Rritja masive e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, rritja e komunikimit të dhënave, dhe kërkesa gjithnjë e më shumë për komunikim të dhënash përkthehet në nevojën e rritjes së kapaciteteve të rrjeteve të komunikimit elektronik, rrjeteve të telekomunikacionit që i përgjigjet më mirë zhvillimeve digjitale dhe transformimit digjital, dhe përdorimit të teknologjise digjitale nga të gjithë sektorët e ekonomisë, nga institucionet publike, nga biznesi dhe qytetarët. Ndërtimi i rrjeteve të komunikimit elektronik me kapacitete të larta (VHCN), nënkupton ndërtimin e rrjeteve të komunikimit elektronik me fibër optike deri në pikën fundore të rrjetit, ku lidhet përdoruesi, ose rrjete 5G apo gjenerata të ardhme si 6G që plotëson kërkesat për shpejtësi gigabit. Plotësimi i kësaj nevoje kërkon marrjen e masave për të nxitur zhvillimin e këtyre rrjeteve dhe që përbëjnë infrastrukturën kryesore mbi të cilën mbështetet zhvillimi digjital dhe gjithë komunikimi elektronik.

Kuadri ligjor ekzistues Ligji nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, ka transpozuar Direktivën 2014/61/BE e cila është shfuqizuar nga Rregullorja e (BE) 2024/1309, “Mbi masat për të ulur koston e ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike Gigabit” e njohur si Akti i Infrastruktures Gigabit (GIA).

Problemi lidhet me nevojën për përditësimin e kuadrit ligjor aktual lidhur me masat për të zvogëluar koston e ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike Gigabit, që synojnë përshtetjen e ndërtimit të Rrjeteve me Kapacitet Shumë të Lartë (VHCN), uljen e kostove të infrastrukturës të komunikimeve elektronike, për harmonizimin e procedurave administrative, lehtësimin e aksesit në infrastrukturat fizike ekzistuese dhe harmonizimin e procedurave në dhënien e lejeve për ndërtimin e këtyre rrjeteve me ato të Bashkimit Evropian. Ulja e kostove në ndërtimin të rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë do të kontribuojë në shtrirjen e rrjeteve digjitale me kapacitete të larta duke rritur penetrimin e infrastrukturës gigabit dhe duke nxitur me tej transformimin digjital të vendit.

Problematikat kryesore të identifikuara mund të përmbledhen si më poshtë:

- Nivel i ulët i penetrimit të lidhjeve Gigabit dhe i bashkëpërdorimit të infrastrukturave ekzistuese;
- Vështirësi në sigurimin e aksesit në infrastrukturat e komunikimeve elektronike në godinat e banimit, komplekset rezidenciale;
- Procedura jo të unifikuara për lejet specifike për rrjetet e telekomunikacionit në nivel qendror dhe vendor dhe vonesa në proceset e bashkëpunimit institucional;
- Mungesa e njoftimeve publike për punimet e planifikuara nga autoritete të ndryshme;
- Mungesa e një sistemi me të gjitha informacionet për infrastrukturën fizike ekzistuese dhe facilitet shoqëruese për të lehtësuar planifikimin, bashkëpërdorimin e infrastrukturave, reduktuar kostot.
- Mungesa e harmonizimit me acquis të BE për infrastrukturën gigabit - GIA;

Arritja e objektivave të përcaktuara në Vendimin (BE) 2022/2481 kërkon që, deri në vitin 2030, të gjithë përdoruesit fundorë në vende fikse të jenë të mbuluar nga një rrjet gigabit deri në pikën e përfundimit të rrjetit dhe të gjitha zonat e populluara të jenë të mbuluara nga rrjete pa tel me shpejtësi të lartë të gjeneratës së ardhshme me performancë të paktën ekuivalente me atë të 5G, në përputhje me parimin e neutralitetit teknologjik. Ofrimi i rrjeteve gigabit deri te përdoruesi fundor duhet të lehtësohet, veçanërisht përmes infrastrukturës fizike brenda ndërtesës të gatshme për fibra. Për të arritur këto objektiva, ekziston nevoja për politika që përshtet, thjeshtojnë dhe ulin kostot e ndërtimit të rrjeteve fikse dhe pa tel me kapacitet shumë të lartë në të gjithë Shqipërinë, duke përfshirë planifikimin e duhur, koordinimin e përmirësuar dhe krijimin e procedurave të thjeshtuara dhe të efektshme të lejeve si një mënyrë për të zvogëluar barrën administrative si mbi operatorët ashtu edhe mbi administratën kombëtare.

Gjithashtu kjo nismë do të forcojë dhe harmonizojë të drejtat dhe detyrimet e zbatueshme për të përshtetur ndërtimin e VHCN-ve. Detyrimi për të dhënë akses në infrastrukturën fizike, duhet të jetë pa paragjykuar të drejtat e pronarit të tokës ose të ndërtesës në të cilën ndodhet infrastruktura.

Koordinimi i punimeve civile në lidhje me infrastrukturën fizike mund të sigurojë kursime të konsiderueshme dhe të minimizojë shqetësimet në zonën e prekur nga vendosja e rrjeteve të reja të komunikimeve elektronike. Procedurat e dhënies së lejeve nuk duhet të përbëjnë pengesa të pajustificuara për investimet ose të dëmtojnë tregun e brendshëm. Prandaj, autoritetet kompetente duhet të sigurojë që një vendim nëse do të japë apo jo leje për vendosjen e elementëve të VHCN-ve ose të objekteve të shoqëruara të vihet në dispozicion brenda katër muajve nga data e marrjes së një kërkesë për leje ose afati i përcaktuar nga ligji kombëtar, cilado që të jetë më i shkurtër.

Për të planifikuar në mënyrë efektive vendosjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe për të siguruar përdorimin më efektiv të infrastrukturave ekzistuese të përshtatshme për vendosjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike, sipërmarrësit që ofrojnë ose janë të autorizuar për të ofruar rrjete publike të komunikimeve duhet të jenë në gjendje të kenë akses në informacionin minimal në lidhje me infrastrukturën fizike të disponueshme në zonën e vendosjes. Ky informacion minimal duhet të bëjë të mundur vlerësimin e potencialit për përdorimin e infrastrukturës ekzistuese në një zonë specifike, si dhe për të zvogëluar dëmet në çdo infrastrukturë fizike ekzistuese.

Ky informacion minimal duhet të vihet në dispozicion nëpërmjet një pike të vetme informacioni që do të lejojë akses në informacionin minimal në format elektronik, me kusht kufizimet për të siguruar sigurinë dhe integritetin e rrjetit, veçanërisht atë të infrastrukturës kritike, ose për të ruajtur sekretet legjitime operative dhe të biznesit.

Përmes rishikimit të legjislacionit kombëtar për rrjetet e komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, synon adresimin e problemativate si dhe permbushjen e objektivave në kuadër të procesit të integritimit evropian dhe reformes së agjendave ku është parashikuar transpozimi i Rregullores (BE) 2024/1309 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 29 prill 2024, “Mbi masat për të ulur koston e ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike Gigabit,” që ndryshon Rregulloren (BE) 2015/2120 dhe shfuqizon Direktivën 2014/61/BE (Akti i Infrastrukturës Gigabit), numri CELEX 32024R1309.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

Nëpërmjet kësaj nisme synohet, të përshpejtohet vendosja e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë (gigabit dhe 5G) në Shqipëri përmes uljes së kostove të investimit, eliminimit të barrierave administrative dhe përmirësimit të koordinimit institucional, në përputhje me Tregun Digjital Evropian, si dhe përmbushja e objektivave të mëposhtme:

- **Reduktimi i kostove të ndërtimit të infrastrukturës broadband me të paktën 30% deri në vitin 2030**, përmes përdorimit të përbashkët të infrastrukturës dhe koordinimit të punimeve civile.
- **Shkurtimi i kohës mesatare për dhënie të lejeve në më pak se 60 ditë deri në vitin 2028**, nëpërmjet krijimit të një sistemi “one-stop-shop” dhe digjitalizimit të proceseve.
- **Rritja e mbulimit me rrjete gigabit në mbi 90% të popullsisë deri në vitin 2035**, duke përfshirë zgjerimin në zonat rurale.
- **Rritja e aksesit broadband në zonat rurale në mbi 95% deri në vitin 2030**, për të reduktuar hendekun digjital.
- **Sigurimi i transparencës së plotë mbi infrastrukturën ekzistuese deri në vitin 2028**, përmes krijimit të një databaze kombëtare të hartëzimit të infrastrukturës fizike.
- **Rritja me të paktën 50% e përdorimit të infrastrukturës së përbashkët deri në vitin 2030**, si rezultat i detyrimeve rregullatore dhe mekanizmave të koordinimit.

- **Rritja e investimeve private në rrjete broadband me të paktën 25% deri në vitin 2030**, duke përmirësuar sigurinë rregullatore dhe klimën e investimit.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së politikave:

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së pa ndërhyrje në kuadrin ligjor ekzistues

Opsioni 1 – Amendimi i kuadrit ligjor ekzistues

Opsioni 2 – Miratimi i një ligji të ri.

Opsioni 3 – Jo rregullator

Opsioni 0: Nënkupton mosndërmarrjen e asnjë politike duke vijuar me funksionimin sipas legjislacionit aktual. Ndikimet ekonomike të këtij opsioni përfshijnë/ndikojnë veçanërisht në boshllëqet e dukshme në aftësitë e rrjeteve të komunikimit elektronik (konektiviteti digjital me shpejtësi të lartë), që ndikojnë në ofrimin e shërbimeve tek familjet dhe bizneset që i përgjigjen kërkesave në rritje për kapacitete të larta në komunikim me infrastrukture gigabit si dhe ne marrjen e shërbimeve të reja që kërkojnë lidhje me gjerësi bande të lartë dhe/ose simetrike dhe pa vonesa për transmetimet në kohe reale.

Nga ana tjetër, lidhjet e dobëta në konektivitetin brenda vendit, mund të kenë ndikime më të gjera në atraktivitetin e Shqipërisë si një qendër për inovacionin dhe zhvillimin e biznesit në TIK. Në këtë kontekst, duhet mbajtur parasysh që kanë industri të mirëzhvilluara të TIK-ut, janë mbështetur nga nxitja e hershme e investimeve për lidhje/konektivitet me shpejtësi shumë të lartë. Rrjetet celulare 4G dhe ato 5G varen nga përdorimi i fibrave optike për të përmbushur kërkesat për "vonesën e ulët/low latency" të nevojshme për aplikacione të tilla si telemjekësia, apo aplikacione të tjera që kërkojnë cilësi të lartë shërbimi.

Mungesa e ndërmarrjes së veprimeve për përsheptimin e zhvillimit dhe investimeve në infrastrukturën digjitale (përkatesisht rrjetet VHCN), për të adresuar kërkesën më të lartë për konektivitet digjital dhe shoqërinë gigabit, do të kishte implikime negative si për aplikacionet në celular, ashtu dhe ato dhe fikse.

Opsioni 1: Amendimi i kuadrit ligjor ekzistues Ligji nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, mund të ishte një opsion por praktikisht duke qenë se një nga objektivat është transpozimi i plotë i Rregullores së BE-së 2024/1309/EU ndryshimet do preknin çdo nen të këtij ligji gjë që e bën me të mbështetur opsionin e një ligji të ri, për të rritur qartësinë ligjore dhe shmangur fragmentizimin e rregullimeve dhe rrezikun për mospërmbushje të objektivave të BE.

Opsioni 2: Hartimi i një ligji të ri, në përputhje të plotë me Rregulloren e BE 2024/1309 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 29 prill 2024, “Mbi masat për të ulur koston e ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike Gigabit,” që ndryshon Rregulloren (BE) 2015/2120 dhe shfuqizon Direktivën 2014/61/BE (Akti i Infrastrukturës Gigabit), numri CELEX 32024R1309. **Ky opsion përfaqëson zgjidhjen më të balancuar dhe efektive.**

Opsioni 3 – Jo rregullator : Ky opsion konsiston në rritjen e bashkëpunimit nderinstitucional, dhe në vazhdimin e zbatimit të kuadrit ekzistues ligjor dhe institucional që rregullon sektorin e komunikimeve elektronike në Shqipëri. Në këtë skenar, autoritetet publike do të mbështeteshin në legjislacionin aktual, aktet nënligjore ekzistuese, udhëzimet administrative, marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe operatorëve, si dhe në masa promovuese dhe koordinuese me karakter jo detyrues për të adresuar problematikat që lidhen me zhvillimin e infrastrukturës së rrjeteve gigabit.

Avantazhi kryesor i këtij opsioni lidhet me faktin se nuk krijon kosto të menjëhershme legislative, institucionale apo administrative për shtetin. Nuk do të kërkohej hartimi dhe miratimi i një kuadri të ri ligjor, ngritja e strukturave të reja administrative, zhvillimi i sistemeve elektronike të informacionit apo trajnimi i personelit për zbatimin e procedurave të reja. Gjithashtu, operatorët dhe subjektet e tjera ekonomike nuk do të përballëshin me detyrime të reja rregullatore në afat të shkurtër.

Megjithatë, ky opsion nuk adreson shkaqet kryesore të problemit që pengojnë zhvillimin e shpejtë dhe efikas të rrjeteve gigabit në Shqipëri. Mungesa e një sistemi të integruar dhe transparent për informacionin mbi infrastrukturën fizike ekzistuese do të vazhdonte të kufizonte mundësitë për ripërdorimin e saj dhe për koordinimin e investimeve.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)

Problemi që synohet të adresohet lidhet me adresimin e problematike si dhe harmonizimi i plotë i kuadrit ligjor kombëtar në fushën e infrastrukturës gigabit me acquis të Bashkimit Evropian. Kuadri aktual paraqet boshllëqe dhe mospërputhje që kufizojnë përafrimin me standardet evropiane, duke mos krijuar një bazë të qartë dhe të plotë ligjore për zbatimin e standardeve për infrastrukturën digjitale gigabit. Kjo situatë pengon avancimin e mëtejshëm të integritimit në tregun evropian të komunikimeve elektronike dhe krijon pasiguri rregullatore për aktorët e përfshirë.

Ndikimet e drejtpërdrejta të opsionit të preferuar (Opsioni 2) :

- Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor kombëtar në përputhje me acquis communautaire të BE-së që synon të forcojë dhe harmonizojë të drejtat dhe detyrimet e zbatueshme në të gjithë sektorin për të përshpejtuar shtrirjen e rrjeteve e VHCN-ve dhe koordinimin ndërsektorial, duke përfshirë rrjetet bazë dhe rrjetet pa tel me shpejtësi të lartë të gjeneratës së ardhshme me performancë të paktën ekuivalente me atë të 5G.
- Përmirësimi i procedurave të dhënies së lejeve për shtrirjen e rrjeteve VHCN. Procedurat e dhënies së lejeve nuk duhet të përbëjnë pengesa të pajustificuara për investimet ose të dëmtojnë tregun e brendshëm. Ky ligj do të siguroj që një vendim nëse do të jepet apo jo leje për vendosjen e elementëve të VHCN-ve ose objekteve të shoqëruara të vihet në dispozicion brenda katër muajve nga data e marrjes së një kërkesë për leje ose afati i përcaktuar nga ligji kombëtar, cilado qoftë më i shkurtër. Ky ligj përcakton aplikimin e procedurës së miratimit të heshtur nga autoritetet kompetente pasi të ketë kaluar një periudhë e caktuar kohore.
- Përmirësimi i shtrirjes së rrjeteve VHCN-ve në tregun e brendshëm, ky ligj do të përcaktojë të drejtat për ndërmarrjet që ofrojnë rrjete publike të komunikimeve elektronike ose objekte të shoqëruara (duke përfshirë ndërmarrjet me natyrë publike) për të aksesuar infrastrukturën fizike pavarësisht nga vendndodhja e saj sipas kushteve të drejta dhe të arsyeshme në përputhje me ushtrimin normal të të drejtave të pronësisë.
- Përmirësimi i procedurave për ripërdorimin e infrastrukturës fizike ekzistuese, kur operatorët kërkojnë akses në një zonë të caktuar, operatorët e rrjetit dhe organet e sektorit publik që zotërojnë ose kontrollojnë infrastrukturën fizike duhet të bashkëpunojnë për përdorimin e përbashkët të objekteve të tyre sipas kushteve dhe afateve të drejta dhe të arsyeshme, duke përfshirë çmimin, përveç nëse aksesimi refuzohet për arsye objektive dhe të justifikuaras.
- Rregullime të qarta ligjore për sipërmarrësit që duhet të kenë akses, me kërkesë, në informacionin minimal mbi infrastrukturën fizike dhe punimet civile të planifikuara në zonën e vendosjes. Kjo do t'u mundësojë atyre të planifikojnë në mënyrë efektive vendosjen e VHCN-ve dhe të sigurojnë përdorimin

më efektiv të infrastrukturës fizike ekzistuese, të përshtatshme për shtrirjen e rrjeteve të tilla, dhe punimet civile të planifikuara.

- Përmirësimi i transparencës të punimeve civile të planifikuara nëpërmjet pikave të vetme të informacionit. Kjo mund të bëhet duke i ridrejtuar operatorët te informacione të tilla, aty ku janë të disponueshme. Transparenca mund të zbatohet gjithashtu duke i bërë kërkesat për dhënien e lejeve të kushtëzuara nga vënia në dispozicion e informacionit mbi punimet civile të planifikuara nëpërmjet një pike të vetme informacioni. Një informacion i tillë minimal është një parakusht për të vlerësuar potencialin për përdorimin e infrastrukturës fizike ekzistuese ose koordinimin e punimeve civile të planifikuara në një zonë specifike, si dhe për të zvogëluar dëmet në çdo infrastrukturë fizike ekzistuese.

Ndikime jo të drejtpërdrejta: zbatimi i politikës së re, sjell përfitim për të gjithë sektorët e ekonomisë në edukim, transport, energji, shëndetësi, institucionet publike etj.

Përfitimet për qeverinë nga opsioni i zgjedhur do të jenë :

Zbatim i Tregut Digjital Evropian. Harmonizim me acquis të BE-së dhe përparim në procesin e integritimit European.

Efikasitet administrativë. Reduktim i burokracisë dhe automatizim i proceseve të lejeve dhe koordinimit .

Zhvillim ekonomik dhe fiskal. Rritje e investimeve private në infrastrukturë dhe rritja e GDP përmes ekonomisë digjitale.

Planifikim më i mirë i territorit. Hartëzim i infrastrukturës ekzistuese dhe koordinim i punimeve publike (rrugë, energji, ujësjellës, fibra). Ulje e ndërhyrjeve të panevojshme publike.

Përfitimet për Operatorët Ekonomikë/Biznesi: Në Shqipëri në fund të vitit 2025, rezultoni të autorizuar nga AKEP, për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, mbi 250 sipërmarrës.

Rritje e konkurrencës dhe hyrjes në treg. Operatorë të rinj mund të hyjnë më lehtë si dhe ulje e barrierave administrative .

Nxitje për investime në rrjete Gigabit. Me shume Siguri ligjore për investitorët dhe mundësi për modele PPP dhe bashkë-investim.

Përfitimet Për Bizneset. Internet më i shpejtë dhe më i lirë për bizneset që do sjelli rritje produktiviteti dhe inovacioni.

Përfitimet për kompanitë e ndërtimit që kryejnë punime inxhinierike. Ulje e kostove të investimit. Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës ekzistuese (kanalizime, shtylla, fibra) do të sjelli reduktim të kostove të gërmimeve (që përbëjnë deri në ~70% të investimit broadband)

Sipas statistikave më të fundit të publikuara nga Qendra Kombëtare e Biznesit, numri i subjekteve aktive në sektorin “Ndërtimi” (për vitin 2025) në Shqipëri është 13,300 kompani/subjekte ndërtimi active. (<https://qkb.gov.al/biznesi-ne-shqiperi>).

Leje ndërtimi, sipas INSTAT për ndërtesa të reja (ndërtime për banim (rezidente), me një kat, me dy kate, me tre ose më shumë kate, rezidenca për komunitetet, ndërtesa të tjera (jo rezidente), hotele dhe të ngjashme, ndërtesa për zyra, ndërtesa tregtare, ndërtesa industriale, ndërtesa të tjera) janë dhënë mbi 750 për vitin 2025. (https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START_ND_NDO/ND0003/table/tableViewLayout1/)

Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit, për vitin 2025 sipas INSTAT shkon në 65.258 milionë lekë për ndërtime të reja sipas llojit të ndërtimit, ndërtesa (ndërtime për banim (rezidente), ndërtesa për komunitetet, ndërtesa të tjera (jo rezidente), hotele dhe të ngjashme, ndërtesa për zyra, ndërtesa tregtare, ndërtesa industriale, ndërtesa të tjera) dhe punime Inxhinierike (Infrastruktura e transportit (Rrugë dhe autostrada), linjat e ujësjellësave, elektrike dhe telekomunikacionit, ndërtime komplekse në kantieret industriale, punime të tjera inxhinierike)

Procedura më të shpejta dhe të parashikueshme. Afate të qarta për leje ndërtimi dhe instalimi. Digjitalizim i aplikimeve (one-stop-shop).

Përfitimet për qytetarët

Internet më i shpejtë dhe më cilësor. Akses në rrjete gigabit dhe 5G dhe përmirësim i shërbimeve online.

Ulje e çmimeve. Konkurrencë më e lartë midis operatorëve dhe kosto më të ulëta që reflektohen në tarifa

Akses më i mirë në zona rurale. Zgjerim i mbulimit broadband dhe reduktimi i “ndarjes dixhitale”

Shërbime publike më të mira, Shërbime më të shpejta dhe transparente. E-government, e-health, e-education

Përmirësim i cilësisë së jetës. Mundësi për punë në distance, edukim dhe shërbime digjitale më të aksesueshme

Përfitime horizontale (cross-cutting)

Transformim digjital i ekonomisë. Mbështetje për industri si fintech, AI, cloud, IoT

Ndikim pozitiv mjedisor. Më pak gjurmime të përsëritura dhe reduktim i emëttimeve përmes optimizimit të punimeve.

Siguri dhe qëndrueshmëri. Infrastruktura më moderne dhe rezistente si dhe mbështetje për rrjete kritike (emergjenca, energjia, etj.)

Lidhur me ndikimet monetare miratimi i këtij projektligji nuk sjell efekte financiare të drejtperdrejta për Buxhetin e Shtetit.

Realizimi i një sistemi funksional me të gjitha informacionet për infrastrukturën fizike ekzistuese dhe facilitet shoqërore për të lehtësuar planifikimin, bashkëpërdorimin e infrastrukturave, reduktuar kostot, shoqërohet me investim që do të kryhet nga AKEP, dhe është vlerësuar në vlerën **rreth 960 mijë Euro**.

Gjithashtu plotësimi i kërkesave për të pasur lidhje me fibër optike në çdo ndërtim të ri deri në pikën fundore të rrjetit do të ketë nevojë për planifikim nga të gjithë investitorët. Por referuar çmimeve të tregut ndryshimi në investim për rrjetin e brendshëm të godinave të reja duke përdorur fibër optike në vend të kabllove coax apo bakër afatgjatë nuk është i ndjeshëm dhe do aplikohet me periudhë tranzitore pas hyrjes në fuqi të ligjit.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Shqipëria është e angazhuar fort në procesin e integritit në tregun e vetëm digjital. Agjenda Kombëtare e Reformave 2024 – 2027, e miratuar me VKM nr. 621, datë 10.10.2024, përfshin nën Fushën politike: “3. Digjitale”, përfshin reforma/masa që lidhen me infrastrukturën digjitale/broadband dhe 5G. Masa 3.1.3 e Agjendës së Reformave lidhet me infrastrukturën digjitale dhe kërkon adoptimin e legjislacionit përkatës me atë Bashkimit Evropian për Aktin e Infrastrukturës Gigabit që është miratuar me Rregulloren e BE-së 2024/1309/EU.

Rritja masive e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, rritja e komunikimit të të dhënave, dhe kërkesa gjithnjë e në rritje për komunikim të dhënash përkthehet në nevojën e rritjes së kapaciteteve të rrjeteve të komunikimit elektronik, rrjeteve të telekomunikacionit që i përgjigjet më mirë zhvillimeve digjitale dhe transformimit digjital, dhe përdorimit të teknologjise digjitale nga të gjithë sektorët e ekonomisë, nga institucionet publike, nga biznesi dhe qytetarët. Në periudhën dhjetëvjeçare nga 2015 në 2025 volumi i trafikut të të dhënave nga rrjetet fikse të telekomunikacionit në Shqipëri është rritur me 32 herë duke

arritur në 2.08 Exabytes për vitin 2025. Po kështu volumi i të dhënave të trafikut nga rrjetet celulare është rritur 22 herë gjatë 2015-2025 dhe gjatë 3-4 viteve të fundit me rreth tre herë.

Kjo kërkesë në rritje për komunikime që mbeshtesin shërbimet publike online, aplikacionet e ndryshme, zhvillimet smart city, digital ekonomi, automatizimin e industrisë etj. kërkon ndërtimin e rrjeteve të komunikimit elektronik me kapacitete të larta (VHCN), me fibër optike deri në pikën fundore të rrjetit, ku lidhet përdoruesi, ose rrjete 5G apo gjenerata të ardhme si 6G që plotëson kërkesat për shpejtësi gigabit.

Opsioni 2, miratimi i një ligji të ri, “*Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta - Akti i Infrastrukturës Gigabit*”, është përzgjedhur si opsioni i preferuar pasi ofron **balancën më të mirë ndërmjet efektivitetit, kostos dhe zbatueshmërisë**, duke adresuar në mënyrë të plotë shkaqet strukturore të problemit në Shqipëri. Opsioni 2 është **proporcional dhe ekonomikisht më efikas**.

Ky opsion:

- adreson drejtpërdrejt reduktimin e **kostove të ndërtimit të infrastrukturës gigabit**, përmes bashkëpërdorimit të infrastrukturës fizike ekzistuese dhe koordinimit të punimeve civile;
- eliminon **fragmentimin administrativ**, përmes krijimit të procedurave të standardizuara dhe sistemit të unifikuar;
- rrit **transparencën dhe sigurinë rregullatore**, duke nxitur investimet private;
- siguron **përafrim të plotë me acquis të BE-së**, duke mbështetur procesin e integritimit europian.

Në krahasim:

- **Opsioni 0 (status quo)** nuk adreson problemin dhe nuk ndihmon në kapërcimin e problematikave të evidentuara;
- **Opsioni 1 (ndërhyrje minimale)** ka ndikim të kufizuar dhe nuk garanton arritjen e objektivave përfshirë ato të integritimit në BE dhe Reformën e agjendave;

Analiza kosto-përfitim (vlerësim monetar indikativ)

1. Institucionet publike/autoriteti rregullator

- Ndikime sociale:
 - Përmirësim i bashkëpunimit mes AKEP dhe organeve të tjera rregullatore dhe autoritetet publike.
 - Rritje e transparencës dhe përgjegjësisë në zbatimin e ligjit.
 - Forcimi i kapaciteteve për rregullimin e harmonizuar me tregun unik digjital të BE.
- Ndikime ekonomike:
 - Përmirësim i efikasitetit administrativ dhe zvogëlim i dublikimeve në procedurat rregullatore.
 - Optimizim i burimeve njerëzore.
 - Mundësi për planifikim më të mirë dhe koordinim të procedurave rregullatore me ato të BE.
- Ndikime financiare për AKEP: Zhvillimi i një sistemi funksional me të gjitha informacionet për infrastrukturën fizike ekzistuese dhe facilitet shoqërore për të lehtësuar planifikimin, bashkëpërdorimin e infrastrukturave, reduktuar kostot, shoqërohet me investim që do të kryhet nga AKEP, dhe është vlerësuar në vlerën **rreth 960 mijë Euro**. Mbulimi për këtë investim do të bëhet nga burimet e të ardhurave të AKEP sipas Ligjit nr. 54/2024 “Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe burime të tjera.

2. Përdoruesit e shërbimeve: qytetarët dhe bizneset

- Ndikime sociale:
 - Rritje e qasjes në infrastrukturën gigabit;

- Rritje e përfitimeve nga shërbimet e komunikimit me kapacitete të larta gigabit me çilesi me të mirë;

3. Ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike në roaming

- Ndikime sociale:
 - Rritje e kënaqësisë së përdoruesve të shërbimeve të komunikimit elektronik Lehtësim i aksesit për qytetarët dhe bizneset në shërbimet e komunikimit në roaming.
- Ndikime ekonomike:
 - Rritje e besueshmërisë dhe imazhit si pjesë e tregut digjital të BE-së
 - Permiresim i infraskuturës digjitale;
- Ndikime financiare:
 - Reduktim të kostove përmes bashkepërdorimit të infrastrukturave, koordinimit të punimeve planifikimit mbi bazen e informacionit transparent;

4. **Investitorët e ndertimeve:** Nevoje në planifikimin e punimeve të brendshme në godina zëvendësimi i rrjeteve nga bakër dhe koax në fiber optike. Por referuar çmimeve të tregut ndryshimi në investim për rrjetin e brendshëm të godinave të reja duke përdorur fiber optike në vend të kabllave coax apo bakër afatgjatë nuk është i ndjeshëm dhe do aplikohet me periudhë tranzitore pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Përfitimet

Ulje e kostove të investimit, dhe rritje e investimeve private. Efekti “crowding-in”. Kjo ndodh kur investimet publike rrisin kërkesën, krijojnë punësim dhe përmirësojnë infrastrukturën, duke i bërë projektet private më fitimprurëse dhe duke rritur besimin e investitorëve.

Kursime nga koordinimi i punimeve për sektorin publik dhe privat: Rritje ekonomike indirekte si dhe rritja e produktivitetit nga digjitalizimi dhe aksesit në shërbimet elektronike

Përfitimet strategjike

Përveç përfitimeve monetare, Opsioni 2 sjell:

- **Përshejtim të transformimit digjital të ekonomisë;**
- **Reduktim të hendekut digjital urban–rural;**
- **Përmirësim të konkurrencës në treg;**
- **Rritje të cilësisë së shërbimeve publike;**
- **Përafrim të plotë me tregun Digjital Evropian.**

Bazuar në analizën krahasuese dhe vlerësimin kosto–përfitim Opsioni 2 siguron **ndikimin më të madh pozitiv neto**, është **financiarisht i përballueshëm** për buxhetin e shtetit dhe garanton **arritjen e objektivave strategjike kombëtare dhe evropiane**.

Për zbatimin e këtij opsioni, organi rregullator, AKEP do të jetë i ngarkuar me zbatimin e rregullimit dhe me krijimin e një sistemi funksional për informacionin për infrastrukturën e komunikimeve elektronike si dhe bashkëpunimin me autoritetet e tjera.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
0	0	0

Zhvillimi i një sistemi funksional me të gjitha informacionet për infrastrukturën fizike ekzistuese dhe facilitet shoqëruese për të lehtësuar planifikimin, bashkëpërdorimin e infrastrukturave, reduktuar kostot, shoqërohet me

investim që do të kryhet nga AKEP, dhe është vlerësuar në vlerën rreth 960 mijë Euro dhe do të mbulojë nga burimet e të ardhurave që AKEP krijon sipas ligjit nr. 54/2024 dhe financime të tjera të ligjshme.

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

Më datë 3 Nëntor 2025, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, së bashku me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare organizuan në Hotel Plaza Tiranë, takimin dialogues mbi politikën dhe reformat në planin e rritjes për infrastrukturën digjitale dhe procesin e integritimit në BE dhe nevojën e përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullator sipas Rregullores së BE 2024/1309 për GIA (Akti i Infrastrukturës Gigabit), transpozimin e këtij akti në një ligj të ri. Në këtë takim kishte përfaqësues të institucioneve rregullatore, Bashkive, ARRSH si dhe përfaqësues nga sipërmarrësit e sektorit të telekomunikacionit. Numri total i pjesëmarrësve në këtë takim ishte 65 persona.

Projektligji është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Projektligji “**Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta - Akti i Infrastrukturës Gigabit**”, në zbatim të ligjit 146/2014, i është nënshtruar procesit të konsultimit publik nëpërmjet publikimit të tij në portalin “Regjistri elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike”, nga data **16.04.2026** deri në datën **14.05.2026**.

Gjatë kësaj periudhe projektligji u publikua edhe në faqen zyrtare të Ministrisë për konsultim.

Gjithashtu, më datën 25.05.2026, Ministria organizoi në ambientet e tij takime konsultative me grupet e interesit të prekura nga ky projektligj. Pjesëmarrësit në këto takime u njoftuan paraprakisht nga Ministria përmes shkresave zyrtare dhe postës elektronike. Gjatë këtyre takimeve u prezantuan risitë kryesore të projektligjit dhe u ftuan përfaqësuesit e grupeve të interesit të shprehnin komentet dhe sugjerimet e tyre.

Më datë 6 Maj 2026, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, së bashku me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare organizuan në Hotel Plaza Tiranë, takimin dialogues “Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta” Akti i Infrastrukturës Gigabit. Në këtë takim kishte përfaqësues institucioneve rregullatore, të Bashkive, AZHT si dhe përfaqësues nga sipërmarrësit e sektorit të telekomunikacionit. Numri total i pjesëmarrësve në këtë takim ishte 60 persona.

Nga takimet konsultative të zhvilluara, pjesëmarrësit ngritën diskutime kryesisht në lidhje me implementimin e ligjit të ri.

Nga publikimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, kanë dërguar komente disa operatorë të komunikimeve elektronike . ONE , Vodafone , Tring\ASC, MadCom. Nga institucionet publike , kanë dërguar komente , AKEP, AZHT, Ministria e Drejtësisë, Kryenegociatori. Komente e dërguara ishin kryesisht të natyrës të lejeve të ndërtimit dhe përcaktimeve ligjore dhe afateve të përcaktuara nga ligji i ri Sugjerimet e dërguara janë shqyrtuar nga Ministria, dhe janë reflektuar në raportin individual të konsultimit publik.

Më datë 25.05.2026, u organizua takim konsultues, në nivel teknik, për Projektligjin “Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta- Akti i Infrastrukturës Gigabit”. Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi dhe trajtimi i komenteve dhe sugjerimeve të paraqitura në kuadër të procesit të konsultimit publik, të cilat u referohen dispozitave të projektligjit. Diskutimet teknike u adresuan nga pjesëmarrësit e institucioneve publike dhe palëve të interesuara në këtë proces.

Gjatë fazës së konsultimit publik, për projekligjin janë sjellë komente nga, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Autoriteti Kombëtar i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, të cilat janë reflektuar në projektligj.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Zbatimi i Opsionit 2, implementimi i plotë i Rregullorja (BE) 2024/1309 (Gigabit Infrastructure Act) do të realizohet përmes miratimit të një ligji të ri “ *Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta - Akti i Infrastrukturës Gigabit*”.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e opsionit të preferuar janë:

- MIE si institucion politikëbërës për tregun e komunikimit elektronik/telekomunikacionit;
- AKEP si organ i pavarur rregullator për tregun e komunikimeve elektronike dhe përgjegjëse për zbatimin e mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike;

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë koordinon politikën kombëtare në fushën e komunikimeve elektronike si dhe ndjek zbatimin e reformës së agjendave dhe procesin e integritit për kapitullin 10.

AKEP është autoriteti rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare në territorin e Republikës së Shqipërisë, i cili vepron në bazë të dispozitave të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, do të jetë autoriteti përgjegjës për zbatimin rregullator dhe teknik, duke monitoruar respektimin e detyrimeve të operatorëve për si dhe ushtrimin e kompetencave për zgjidhjen e mosmarreveshjeve në bashkëpunim me autoritetet e tjera rregullatore dhe Bashkitë.

Në kuadër të zbatimit të ndryshimeve ligjore të ritshme, MIE si institucioni politikëbërës pritet të hartojë dhe propozojë një draft VKM dhe AKEP si organi rregullator do të hartojë dhe miratojë dy akte rregullatore.

Institucione të tjera publike/autoritete kompetente të lidhura ose/të ngarkuara për aspekte të tilla si, Bashkitë, Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe dhenien e lejeve, apo dhe ente të tjera publike që zoterojnë infrastruktura fizike që mund të hostojnë rrjete VHCN.

Vlerësimi i progresit do të kryhet në mënyrë të rregullt për të mundësuar përmirësime të vazhdueshme në Shqipëri. Zbatimi i ndryshimeve të politikave të përfshira në opsionin e preferuar do të monitorohet në mënyrë periodike nëpërmjet raporteve vjetore të AKEP, dhe/ose MIE.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Qeveria shqiptare është e angazhuar për transformimin digjital dhe përmbushjen e objektivave të Agjendës Digjitale, në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Programit të Reformave Ekonomike.

Zhvillimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike, dhe ofrimi i shërbimeve përmes tyre, është sot një domosdoshmëri. Infrastruktura e rrjeteve broadband është infrastrukturë e rëndësisë kritike që mund të luajë një rol domethënës në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe social të vendit, si dhe për të shfrytëzuar fuqitë transformuese të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në të gjithë vendin. Për rëndësinë

që paraqet infrastruktura digjitale, për zhvillimin e gjithë ekonomisë, në veçanti në erën e transformimit digjital, u miratua me VKM nr. 434 datë 3.6.2020, Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale, Broadband 2020-2025, i cili ka përcaktuar si vizion: “Shqipëria me infrastrukturë digjitale broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit”.

Ekonomia dixhitale po e ndryshon thellësisht tregun e brendshëm. Me inovacionin, shpejtësinë dhe shtrirjen e saj përtej kufijve, ajo ka potencialin ta çojë integrimin e tregut të brendshëm në një nivel të ri. Vizioni i Shqipërisë është ai i një ekonomie dixhitale që ofron përfitime të qëndrueshme ekonomike dhe sociale bazuar në shërbime moderne online dhe lidhje të shpejta interneti. Një infrastrukturë dixhitale me cilësi të lartë mbështet pothuajse të gjithë sektorët e një ekonomie moderne dhe inovative dhe është me rëndësi strategjike për kohezionin social dhe territorial. Prandaj, të gjithë qytetarët, si dhe sektorët privatë dhe publikë, duhet të kenë mundësinë të jenë pjesë e ekonomisë dixhitale.

Evolucioni i shpejtë i teknologjive, rritja eksponenciale e trafikut të internetit me brez të gjerë dhe kërkesa në rritje për lidhje të përparuar me kapacitet shumë të lartë janë përshpejtuar më tej gjatë pandemisë COVID-19. Disponueshmëria prej vetëm 30 Mbps nuk është më e qëndrueshme për të ardhmen dhe nuk është në përputhje me objektivat e reja të përcaktuara në Direktivën (BE) 2018/1972 për sigurimin e lidhjes dhe disponueshmërisë së gjerë të VHCN-ve.

Në periudhën dhjetëvjeçare nga 2015 në 2025 volumi i trafikut të të dhënave nga rrjetet fikse të telekomunikacionit në Shqipëri është rritur me 32 herë duke arritur në 2.08 Exabytes për vitin 2025. Po kështu volumi i të dhënave të trafikut nga rrjetet celulare është rritur 22 herë gjatë 2015-2025 dhe gjatë 3-4 viteve të fundit me rreth tre herë.

Me ligjin nr. nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Shqipëria ka bërë një përafrim të lartë të Direktivës 2018/1972/EU, Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike, dhe vendosi si objektiv ndërtimin e rrjeteve të kapaciteve të larta të komunikimit (VHCN) që parashikon shpejtesi komunikimi mbi 100 Mbit/s. Kuadri ligjor në fuqi për rrjetet e shpejtësisë së lartë, Ligji nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” ka një përcaktim për 30 Mbit/s .

Problemi në shqyrtim

1. *Përshkruani natyrën e problemit.*
2. *Identifikoni shkaqet e problemit.*
3. *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
4. *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
5. *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

2. Problemi në shqyrtim

Kuadri aktual ligjor dhe procedural nuk siguron masa të mjaftueshme për reduktimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve gigabit, koordinimin e punimeve civile, aksesin në infrastrukturën fizike ekzistuese dhe harmonizimin e procedurave të lejeve. Si rezultat, investimet në rrjetet me kapacitet shumë të lartë përballen me vonesa, kosto shtesë dhe pengesa administrative, duke ndikuar negativisht në objektivat kombëtare të lidhjes gigabit dhe harmonizimit me acquis të Bashkimit Evropian.

• **Natyrë e problemit.** Ndërtimi i infrastrukturës broadband, shoqërohet me kosto të larta kryesisht për shkak të punimeve civile (gërmime, kanalizime), procedura të fragmentuara dhe të gjata administrative për leje dhe autorizime, mungesë koordinimi ndërmjet operatorëve dhe institucioneve publike, akses të kufizuar në infrastrukturën ekzistuese fizike (shtylla, tubacione, rrjete energjie), mungesë transparence mbi infrastrukturën ekzistuese (mungesë hartëzimi të plotë).

• Shkaqet e problemit. Shkaqet kryesore që pengojnë zhvillimin e rrjeteve gigabit dhe 5G janë:

- Shkaqe rregullatore. Kornizë ligjore pjesërisht e përafuar me BE (p.sh. Ligji nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, nuk adreson plotësisht kërkesat e ligjit të ri. Mungesë detyrimesh të qarta për ndarjen e infrastrukturës.
- Shkaqe institucionale. Koordinim i dobët midis bashkive, autoriteteve rrugore, energjisë dhe operatorëve. Mungesë e një “one-stop-shop” funksional për lejet.
- Shkaqe ekonomike. Kosto shumë e lartë e punimeve civile (deri 60–70% e investimit). Pasiguri për kthimin e investimit në zona rurale.
- Shkaqe teknike/informative. Mungesë e databazave të centralizuara për infrastrukturën ekzistuese. Transparencë e kufizuar për planifikimin e punimeve publike.

• Shtrirja e problemit

Problemi prek si zonat urbane ashtu edhe ato rurale, më i theksuar në zona rurale dhe të thella (ku investimet janë më pak tërheqëse), zona urbane me densitet të lartë (ku mungon koordinimi i punimeve dhe ka mbivendosje gjermimesh). Pasojat përfshijnë, zhvillim të ngadalshëm të rrjeteve gigabit, diferenca në aksesin digjital (urban vs rural), kosto më të larta për përdoruesit finalë, humbje të mundësive ekonomike.

• Grupet e prekura

- Qeveria dhe institucionet publike

Ministritë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Autoritetet rregullatore AKEP dhe bashkitë përballen me procese joefikase, mungesë koordinimi, presion për përmbushjen e objektivave të BE-së.

- Bizneset (operatorë dhe investitorë)

Operatorët e komunikimeve elektronike dhe ndërmarrjet e ndërtimit dhe infrastrukturës përballen me kosto të larta, vonesa në leje, pasiguri rregullatore.

- Shoqëria civile dhe organizatat

OJF në fushën e zhvillimit digjital dhe transparencës, preken nga mungesa e aksesit të barabartë, transparencë e kufizuar në vendimmarrje.

- Qytetarët

Përdoruesit fundorë (familjet, studentët, punonjësit) preken nga cilësi e ndryshueshme e internetit, çmime relativisht më të larta, akses i kufizuar në zona rurale.

• A mund të trajtohet problemi përmes ndryshimit të politikave? Po – në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë.

Implementimi i nismës adreson drejtpërdrejt shkaqet e identifikuara:

- **Masa rregullatore.** Detyrime për akses në infrastrukturën fizike. Afate të detyrueshme për dhënien e lejeve.
- **Masa institucionale.** Krijimi i “one-stop-shop” për lejet dhe platforma digjitale për aplikime dhe koordinim.
- **Masa ekonomike.** Ulje e kostove përmes ndarjes së infrastrukturës dhe nxitje për investime private.
- **Masa teknike.** Hartëzim i infrastrukturës ekzistuese dhe transparencë për punimet civile të planifikuara.

Pa ndërhyrje politike tregu nuk i zgjidh vetë këto probleme për shkak të kostove të larta dhe mungesës së koordinimit (market failure). Me implementimin e nismës, krijohet një kornizë e integruar që adreson njëkohësisht aspektet rregullatore, institucionale dhe ekonomike. Problemi është strukturor dhe sistemik, dhe lidhet me kosto të larta, fragmentim institucional, mungesë transparence.

Traspozimi i Rregullores (BE) 2024/1309 (Gigabit Infrastructure Act) në ligjin e ri “Mbi masat për të ulur koston e ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike Gigabit ” përbën një ndërhyrje të domosdoshme dhe proporcionale politike, e cila adreson drejtpërdrejt shkaqet e problemit, përmirëson efikasitetin e tregut, përshpejton transformimin digjital të Shqipërisë.

Arsyeja e ndërhyrjes

6. *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
7. *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
8. *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
9. *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Nevoja për ndërhyrje

Ndërhyrja e qeverisë është të kontribuojë në arritjen e synimit që Shqipëria të ketë një infrastrukturë digjitale broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit përmes krijimit të një kuadri ligjor e rregullator adekuat me ndryshimet e zhvillimet e vrullshme në sektorin digjital dhe me qëllim adresimin e sfidave me të cilat përballlet tregu për të adresuar boshllëqet dhe problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të legjislacionit aktual.

Tregu i komunikimeve elektronike (telekomunikacioneve) përballlet me një sërë sfidash. Shtrirja e rrjeteve fikse Broadband është shumë e ulët në zonat rurale dhe ekziston një hendek i ndarjes digjitale midis zonës urbane dhe rurale. Kërkesat për kapacitet të rrjeteve të telekomunikacionit për internet (si për rrjetet fikse ashtu edhe ato celulare), po rriten me shpejtësi. Këta faktorë kërkojnë më shumë investime të përshpejtuara, për të plotësuar këto nevoja dhe për të arritur objektivat e shoqërisë gigabit.

Qeveria e konsideron të nevojshme ndërhyrjen për shkak të **dështimeve të tregut dhe boshllëqeve rregullatore** që pengojnë zhvillimin e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë. Konkretisht kemi **kosto të larta të investimit** në infrastrukturë (sidomos punimet civile) që nuk përballohen lehtësisht nga operatorët pa mekanizma ndihmës, si dhe **fragmentim institucional dhe administrativ**, me procedura të shumta dhe të paunifikuara për leje ndërtimi dhe instalimi. **Mungesë koordinimi** midis operatorëve dhe autoriteteve publike për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës dhe punimeve civile. **Asimetri informacioni** mbi infrastrukturën ekzistuese, që pengon planifikimin efikas të investimeve.

Në këto kushte, ndërhyrja publike është e domosdoshme për të krijuar një **kornizë të unifikuar dhe të parashikueshme**, reduktuar barrierat hyrëse në treg, përshpejtuar zhvillimin e infrastrukturës digjitale.

Kjo nismë përbën një hap të rëndësishëm në procesin e përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian, në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian.

Çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje

Përmes kësaj nisme legjislative, qeveria synon të adresojë drejtpërdrejt problematikat strukturore të identifikuar, përmes:

- Uljes së kostove të ndërtimit të rrjeteve. Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës ekzistuese. Koordinimi i punimeve civile
- Thjeshtimit dhe përshpejtimit të procedurave. Vendosja e afateve të detyrueshme për leje. Digjitalizimi i proceseve (one-stop-shop)
- Rritjes së transparencës dhe informacionit. Hartëzim i infrastrukturës fizike. Publikim i planeve të punimeve publike
- Nxitjes së investimeve private. Ulje e rrezikut rregullator. Përmirësim i sigurisë juridike
- Në thelb, ndërhyrja synon të krijojë një ekosistem të favorshëm për zhvillimin e rrjeteve gigabit dhe 5G.

Si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë

Nisma mbështet drejtpërdrejt objektivat strategjike të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në disa drejtime të rëndësishme:

- Eshtë në përputhje me angazhimet e Shqipërisë në kuadër të Reformes së Agjendave, Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2025–2027 dhe synon përafrimin me Rregulloren 2024/1309 BE për (GIA) dhe me Tregu Digjital Evropian. Përmbushje e kërkesave të kapitujve të negociatave (Kapitulli 10 – Shoqëria e Informacionit dhe Media).
- Synon të forcojë transformimin digjital dhe Përmirësim të infrastrukturës bazë për shërbime digjitale (e-government, e-health, e-education, transformimin digjital).
- Krijon bazën për zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë. Mbështetje për bizneset digjitale dhe inovacionin. Rritje e produktivitetit dhe investimeve .
- Synon të krijojë një mjedis të sigurt për zhvillimin e balancuar territorial. Reduktim i hendekut digjital midis zonave urbane dhe rurale duke siguruar ërfshirje më e gjerë sociale dhe ekonomike.
- Krijon bazën për rritjen e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve publike nëpërmjet identifikimit elektronik të besueshëm dhe shërbimeve të besuara, duke mundësuar ofrimin e tyre në mënyrë të sigurt dhe të aksesueshme për qytetarët dhe subjektet private.

Puna ekzistuese që është realizuar tashmë

Shqipëria ka ndërmarrë tashmë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim, të cilët krijojnë bazën për implementimin e nismës :

- Korniza ligjore dhe rregullore. Miratimi i ligjit 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit, si dhe akteve nënligjore dhe rregulloreve për aksesin dhe menaxhimin e rrjeteve.
- Reforma në sektorin e komunikimeve elektronike. Forcimi i rolit të autoritetit rregullator në parashikuara në ligjin 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
- Investime në infrastrukturë broadband. Zhvillim i rrjeteve me fibër optike.
- Digjitalizimi i shërbimeve publike. Platforma kombëtare për shërbime onlinedhe rritje të kërkesës për lidhje me cilësi të lartë.
- Përpjekje për përafrim me BE. Analiza paraprake dhe gap analysis midis legjislacionit kombëtar dhe ligjit të ri. Angazhime në kuadër të proceseve të integritit European.

Objektivi i politikës

1. *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
2. *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
3. *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Nëpërmjet kësaj nisme synohet, të përshpejtohet vendosja e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë (gigabit dhe 5G) në Shqipëri përmes uljes së kostove të investimit, eliminimit të barrierave administrative dhe përmirësimit të koordinimit institucional, në përputhje me Tregu Digjital Evropian, si dhe përmbushja e objektivave të mëposhtme:

- **Reduktimi i kostove të ndërtimit të infrastrukturës broadband me të paktën 30% deri në vitin 2030**, përmes përdorimit të përbashkët të infrastrukturës dhe koordinimit të punimeve civile.
- **Shkurtimi i kohës mesatare për dhënien e lejeve në më pak se 60 ditë deri në vitin 2028**, nëpërmjet krijimit të një sistemi “one-stop-shop” dhe digjitalizimit të proceseve.

- **Rritja e mbulimit me rrjete gigabit në mbi 90% të popullsisë deri në vitin 2035**, duke përfshirë zgjerimin në zonat rurale.
- **Rritja e aksesit broadband në zonat rurale në mbi 95% deri në vitin 2030**, për të reduktuar hendekun digjital.
- **Sigurimi i transparencës së plotë mbi infrastrukturën ekzistuese deri në vitin 2028**, përmes krijimit të një databaze kombëtare të hartëzimit të infrastrukturës fizike.
- **Rritja me të paktën 50% e përdorimit të infrastrukturës së përbashkët deri në vitin 2030**, si rezultat i detyrimeve rregullatore dhe mekanizmave të koordinimit.
- **Rritja e investimeve private në rrjete broadband me të paktën 25% deri në vitin 2030**, duke përmirësuar sigurinë rregullatore dhe klimën e investimit.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

1. *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
2. *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
3. *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së politikave dhe janë identifikuar përmes: analizës së boshllëqeve midis kuadrit aktual dhe kërkesave të ligjit të ri , praktikave më të mira të vendeve të BE, konsultimeve me palët e interesuara (operatorë, institucione, ekspertë), vlerësimin të alternativave sipas kritereve të: efektivitetit, koston, zbatueshmërisë, përputhshmërisë me objektivat strategjike.

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së pa ndërhyrje në kuadrin ligjor ekzistues

Opsioni 1 – Amendimi i kuadrit ligjor 120/2016 .

Opsioni 2 – Miratimi i një ligji të ri.

Opsioni 3 – Jo rregullator

Opsioni 0 (ruajtja e status quo-së): Ky opsion konsiston në mospërfshirjen e asnjë ndërhyrjeje të re legjislative, Ky opsion nënkupton vazhdimin e kuadrit aktual ligjor dhe rregullator, bazuar kryesisht në Ligji nr. 120/2016 për komunikimet elektronike dhe aktet ekzistuese nënligjore. Ky opsion do të thotë, mosbërjen e ndryshime, vijimi me të njejtat politikat duke pritur që situata të vetërregullohet nga tregu. Ky opsion nuk adreson shkaqet kryesore të problemit. Ky opsion nuk ka kosto financiare dhe nuk kërkon burime njerëzore, përveç fazës së monitorimit, nuk adreson shkaqet kryesore të problemit dhe nuk jep zgjidhje për problematikat e evidentuara.

Vlerësim i opsionit:

- **Avantazhe:** Nuk krijon kosto shtesë financiare ose burime shtesë njerëzore, kërkon vetëm mbajtjen në fuqi dhe monitorimin e dispozitave ekzistuese.
- **Disavantazhe:** Ky opsion nuk ofron zgjidhje për problematikat e evidentuara si kostot e larta të investimit mbeten të pandryshuara, procedurat administrative vazhdojnë të jenë të fragmentuara, zhvillimi i rrjeteve gigabit mbetet i ngadaltë, hendeku digjital urban–rural thellohet.. Ruajtja e status quo-së pengon gjithashtu edhe përpjekjet për përafrim me *acquis communautaire* të BE-së.

Opsioni 1: Ndërhyrje minimale (përshtatje e pjesshme) Amendimi i ligjit aktual nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së

kalimit". Ky opsion mundëson ruajtjen e një strukturë të njohur për aktorët institucionalë dhe për tregun dhe teorikisht mund të konsiderohet si alternativë me kosto më të ulët në afat të shkurtër. Ky opsion parashikon: ndryshime të kufizuara ligjore, përmirësime administrative pa reformë të plotë strukturore, masa jo të detyrueshme për koordinim dhe transparencë.

- **Avantazhe:** Kosto më e ulët implementimi afatshkurtër, adaptim gradual i institucioneve.
- **Disavantazhe:** Ndikim i kufizuar në uljen e kostove, mungesë e efektivitetit në koordinim dhe akses në infrastrukturë, rrezik për mospërbushje të objektivave të BE.

Opsioni 2: Hartimi i një ligji të ri, në përfrim të plotë me Rregulloren e (BE) 2024/1309 (Gigabit Infrastructure Act), do të përmirësojë dhe do të caktojë krijimin e mekanizmave të detyrueshëm për ndarjen e infrastrukturës, vendosjen e një sistemi "one-stop-shop" për lejet, hartëzimin dhe transparencën e infrastrukturës fizike, koordinim të detyrueshëm të punimeve civile.

Ky opsion përfaqëson alternativën e përzgjedhur dhe më të favorshme në drejtim të përmbushjes së objektivave strategjike dhe rregullatore.

Avantazhe: Ulje e ndjeshme e kostove, rritje e investimeve dhe konkurrencës, përshpejtim i zhvillimit të rrjeteve gigabit, përputhje e plotë me standardet e BE.

Disavantazhe: Ligji i kërkon reforma institucionale dhe kapacitete administrative. Ka një kosto të fillestare për implementimin e kuadrit të ri, si dhe për ngritjen e strukturave mbështetëse institucionale dhe teknike. Megjithatë, këto kosto justifikohen nga përfitimet afatgjata në përmbushjen e politikave të qeverisë.

Objektivi është të adresohet mbulimi i ulët dhe përdorimi i kufizuar i lidhjeve me kapacitet shumë të lartë dhe arsyet për investime jo optimale në Shqipëri. Prandaj, Shtrirja e rrjeteve VHCN duhet të nxitet duke vënë theksin tek rritja e konkurrencës në infrastrukturë, kur është e mundur, bashkëinvestimi, modelet e infrastrukturës (vetëm me shumicë), tek masat për uljen e kostos në bazë të kthimit adekuat të investimit.

Opsioni 3 – Jo rregullator: Ky opsion konsiston në rritjen e bashkëpunimit nderinstitucional, dhe në vazhdimin e zbatimit të kuadrit ekzistues ligjor dhe institucional që rregullon sektorin e komunikimeve elektronike në Shqipëri. Në këtë skenar, autoritetet publike do të mbështeteshin në legjislacionin aktual, aktet nënligjore ekzistuese, udhëzimet administrative, marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe operatorëve, si dhe në masa promovuese dhe koordinuese me karakter jo detyrues për të adresuar problematikat që lidhen me zhvillimin e infrastrukturës së rrjeteve gigabit.

Avantazhi kryesor i këtij opsioni lidhet me faktin se nuk krijon kosto të menjëhershme legjislative, institucionale apo administrative për shtetin. Nuk do të kërkohej hartimi dhe miratimi i një kuadri të ri ligjor, ngritja e strukturave të reja administrative, zhvillimi i sistemeve elektronike të informacionit apo trajnimi i personelit për zbatimin e procedurave të reja. Gjithashtu, operatorët dhe subjektet e tjera ekonomike nuk do të përballeshin me detyrime të reja rregullatore në afat të shkurtër.

Megjithatë, ky opsion nuk adreson shkaqet kryesore të problemit që pengojnë zhvillimin e shpejtë dhe efikas të rrjeteve gigabit në Shqipëri. Mungesa e një sistemi të integruar dhe transparent për informacionin mbi infrastrukturën fizike ekzistuese do të vazhdonte të kufizonte mundësitë për ripërdorimin e saj dhe për koordinimin e investimeve.

Nga perspektiva ekonomike, ky opsion do të ndikonte negativisht në ritmin e investimeve në rrjetet me kapacitet shumë të lartë, veçanërisht në zonat rurale dhe më pak të zhvilluara ekonomikisht, ku kostot e vendosjes së rrjeteve janë më të larta dhe kthimi i investimit është më i ulët. Si rezultat, mund të zgjerohej hendeku dixhital ndërmjet zonave urbane dhe rurale, duke kufizuar aksesin e qytetarëve dhe bizneseve në

shërbime dixhitale moderne, ekonomi dixhitale, shërbime publike online, telemjekësi, arsim në distancë dhe aplikime të avancuara që kërkojnë lidhje me kapacitet shumë të lartë.

Nga perspektiva institucionale dhe e integritit evropian, ky opsion nuk do të sigurojë përafrimin e legjislacionit kombëtar me acquis-in e Bashkimit Evropian në fushën e infrastrukturës gigabit. Duke qenë se GIA përfaqëson instrumentin kryesor të BE-së për reduktimin e kostove dhe përshejtimin e vendosjes së rrjeteve gigabit, mungesa e transpozimit dhe zbatimit të masave të saj do të krijonte një boshllëk rregullator ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve anëtare të BE-së. Kjo mund të ndikojë negativisht në përmbushjen e angazhimeve të procesit të anëtarësimit, në realizimin e objektivave të Agjendës Digjitale dhe në aftësinë e vendit për të përfituar nga iniciativat dhe fondet evropiane që mbështesin zhvillimin e infrastrukturës dixhitale.

Për rrjedhojë, megjithëse opsioni jo-rregullator paraqet kosto minimale në afat të shkurtër dhe shmang nevojën për ndërhyrje legjislative, ai nuk është i aftë të adresojë në mënyrë efektive problemet e identifikuar, nuk siguron arritjen e objektivave të politikës publike dhe nuk mundëson përfitimet ekonomike, sociale dhe teknologjike që priten nga zbatimi i Gigabit Infrastructure Act. Për këtë arsye, ky opsion nuk konsiderohet si alternativa e preferuar për zgjidhjen e problemit të identifikuar.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

1. *Identifikoni grupet e prekura.*
2. *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
3. *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 1. *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 2. *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 3. *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
 4. *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
4. *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 1. *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 2. *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
5. *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 1. *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 2. *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
6. *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 1. *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 2. *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 3. *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Grupet e prekura nga miratimi i ligjit të ri janë:

- Qeveria dhe institucionet publike (ministritë, bashkitë, autoritetet rregullatore)
- Bizneset (operatorët e komunikimeve elektronike, ndërmarrjet e ndërtimit)

- Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) / Kompanitë e ndërtimit
- Qytetarët (përdoruesit fundorë)
- Shoqëria civile dhe organizatat e interesit publik

2. Llojet e ndikimeve (direkte dhe indirekte)

Grupi	Ndikime direkte	Ndikime indirekte
Qeveria	Kosto implementimi, efikasitet administrativ	Rritje e të ardhurave fiskale
Bizneset	Ulje kostosh, rritje investimesh	Rritje produktiviteti
NVM	Akses më i lirë në rrjete	Zgjerim tregu
Qytetarët	Internet më i mirë dhe më i lirë	Cilësi jete, punësim
Shoqëria civile	Transparencë më e lartë	Pjesëmarrje dhe inovacion

3. Ndikimet e drejtpërdrejta

3.1 Analiza cilësore

Qeveria. Rritje e efikasitetit përmes digjitalizimit të proceseve. Përmirësim i koordinimit ndërinstytucional.

Bizneset. Ulje e ndjeshme e kostove të investimit. Procedura më të shpejta dhe më të parashikueshme

Qytetarët. Akses më i mirë në broadband . Ulje e çmimeve të shërbimeve.

3.2 Analiza sasiore (vlerësime indikative)

Indikatori	Baseline	Pas ndërhyrjes	Ndryshimi
Kosto e ndërtimit të rrjetit	100%	70%	-30%
Koha për leje	>90 ditë	<60 ditë	-50%
Mbulimi gigabit	~50%	90%	+40 pp
Akses rural	~60%	90%	+30 pp

Ndikimi mbi NVM

- **Pozitiv:**
 - ulje e kostove të aksesit në internet,
 - mundësi për tregti elektronike dhe shërbime digjitale,
 - hyrje më e lehtë në tregje të reja.
- **Rrezik minimal:**
 - kosto të kufizuara nga adaptimi teknologjik.

4. Ndikimet jo të drejtpërdrejta

4.1 Analiza cilësore

- Rritje e inovacionit dhe zhvillimit të sektorëve digjitalë
- Përmirësim i arsimit dhe shëndetësisë përmes teknologjisë
- Rritje e punësimit në sektorë të lidhur me teknologjinë

Ndikimi mbi konkurrencën - Rritje e konkurrencës përmes:

- aksesit të detyrueshëm në infrastrukturë,
- reduktimit të barrierave hyrëse;

Reduktim i praktikave monopolistike”

- Mundësi për hyrje të operatorëve të rinj.

Kufizimet e analizës:

Supozimet kryesore

- Implementim i plotë dhe korrekt i ligjit të ri ;
- Stabilitet rregullator dhe institucional;
- Nivel i qëndrueshëm investimesh private.

Rreziqet

- Kapacitete të kufizuara administrative;
- Vonesa në krijimin e platformave digjitale;
- Rezistencë nga aktorët ekzistues të tregut.

Faktorë pengues

- Mungesë koordinimi ndërinstytucional;
- Financim i pamjaftueshëm për fazën fillestare;
- Zbatim jo uniform në nivel vendor.

Operatorët Ekonomikë/Biznesi: Në Shqipëri në fund të vitit 2025, rezultonin të autorizuar nga AKEP, për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, mbi 250 sipërmarrës. Për qeverinë, opsioni i preferuar do të sjellë arritjen e nje objektivi strategjik për një shoqëri gigabit. Qytetarët do të përfitojnë pasi zhvillimi i infrastrukturës të komunikimeve elektronike dhe shërbimet e ofruara mbi to me cmime të përballueshme dhe të kudondodhura, rrisin mundësinë e përfitimit nga transformimi digjital dhe përdorimi i TIK nga çdo individ, në marrjen e shërbimeve, aplikacioneve, përdorimin e teknologjive të reja, krijimin e hapësirave për punësim, edukim, e-health, e-commerce etj

Ndikimet financiare

Zbatimi i ligjit të ri kërkon investime fillestare të moderuara publike për platforma digjitale dhe forcim institucional. Në afat mesëm, efekti neto është pozitiv për buxhetin dhe ekonominë, duke rritur eficiencën e investimeve dhe të ardhurat fiskale.

Ndikimet sociale

Reforma pritet të ketë ndikim të fortë pozitiv social përmes rritjes së aksesit në internet me shpejtësi të lartë, reduktimit të hendekut digjital dhe përmirësimit të shërbimeve publike digjitale (e-government, e-health, e-education). Ajo rrit përfshirjen sociale dhe ekonomike, sidomos në zonat rurale, dhe krijon mundësi të reja punësimi dhe zhvillimi ekonomik.

VLERËSIMI I NDIKIMEVE SIPAS KATEGORIVE

Në përgjithësi, ndikimet e implementimit të plotë të GIA janë **pozitive në të gjitha kategoritë kryesore**, me përfitime veçanërisht të forta në dimensionin social dhe ekonomik, duke mbështetur transformimin digjital dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Shqipëri.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

1. *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
2. *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i preferuar është **Opsioni 2**: hartimi dhe miratimi i një ligji të ri “ Mbi masat për të ulur koston e ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike Gigabit”, i cili transponon rregulloren e (BE) 2024/1309 (Gigabit Infrastructure Act), i cili synon harmonizimin e plotë të kuadrit ligjor kombëtar me kërkesat e BE-së për zhvillimin e infrastrukturës gigabit.

Ky opsion është përzgjedhur pasi, në bazë të analizës krahasuese, ai siguron nivelin më të lartë të arritjes së objektivave të politikës, duke adresuar në mënyrë të plotë problemet strukturore si kostot e larta të ndërtimit të rrjeteve, procedurat e fragmentuara administrative dhe mungesën e koordinimit ndër-institucional.

Arsyetimi mbështetet në faktin se Opsioni 2 ofron **balancën më të mirë midis kostos dhe përfitimit**, me një raport shumë pozitiv kosto-përfitim, ku përfitimet ekonomike dhe sociale (rritje investimesh, ulje kostosh për operatorët, përmirësim i aksesit në shërbime digjitale) tejkalojnë ndjeshëm kostot fillestare publike. Gjithashtu, ai rezulton më efikas krahasuar me opsionin minimal (i cili ka ndikim të kufizuar) dhe më i qëndrueshëm financiarisht se opsioni i zgjeruar (i cili ka kosto më të larta fiskale).

Opsioni 2 vlerësohet si zgjidhja më e përshtatshme sepse siguron **efektivitet të lartë, kosto të arsyeshme dhe përputhje të plotë me objektivat e integritet evropian dhe zhvillimit të rrjeteve gigabit**.

Ky vlerësim rezulton edhe nga analiza e kosto – përfitimit, kosto – efektivitetit dhe analiza me shumë kriterë, pasqyruar më poshtë si vijon:

Opsioni 2 – ofron kombinimin më optimal ndërmjet ndikimit ekonomik, social dhe institucional, në krahasim me opsionet alternative (status quo, ndërhyrje minimale dhe ndërhyrje të zgjeruar). Ai siguron arritjen e plotë të objektivave strategjike për zhvillimin e rrjeteve gigabit dhe uljen e barrierave strukturore në vendosjen e infrastrukturës dixhitale.

Nga analiza **kosto-përfitim**, Opsioni 2 rezulton me një **raport shumë pozitiv përfitim/kosto (rreth 5:1 deri në 8:1)**. Kostot publike janë të moderuara dhe të përqendruara kryesisht në fazën e parë të zbatimit (platforma digjitale, forcim kapacitetesh), ndërsa përfitimet ekonomike janë dukshëm më të larta, përfshirë kursime për operatorët, rritje të investimeve private dhe efekte pozitive në produktivitetin ekonomik.

Në aspektin e **kosto–efektivitetit**, Opsioni 2 rezulton më eficient sepse arrin objektivat e politikës me një nivel të arsyeshëm shpenzimesh publike, duke shmangur si mungesën e ndikimit të opsionit minimal ashtu edhe barrën e tepërt fiskale të një ndërhyrjeje të zgjeruar. Ai maksimizon rezultatet për çdo njësi të koston së investuar, veçanërisht në reduktimin e kostove të ndërtimit të infrastrukturës dhe përshpejtimin e vendimmarrjes administrative.

Analiza merr në konsideratë ndikimet mbi administratën publike, operatorët e komunikimeve elektronike, bizneset, qytetarët dhe ekonominë në tërësi. **Kostot e pritshme**

Kostot për administratën publike

a) Hartimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor

Përfshin:

- përgatitjen e ligjit të ri;
- hartimin e akteve nënligjore;
- konsultimet publike;
- trajnimet për institucionet zbatuese.

Vlerësim: Kosto e ulët deri mesatare, e përqendruar kryesisht gjatë 2 viteve të para të zbatimit.

b) Krijimi i Single Information Point (SIP)

GIA kërkon krijimin e një platforme dixhitale për:

- informacion mbi infrastrukturën fizike;
- koordinimin e punimeve civile;
- procedurat e lejeve;
- monitorimin e afateve.

Për Shqipërinë kjo mund të realizohet nga AKEP nw bashpëpunim me institucione të tjera.

Kosto e pritshme:

- zhvillim sistemi IT;
- servera dhe siguri kibernetike;
- mirëmbajtje dhe përditësime.

Vlerësim: Kosto mesatare fillestare dhe kosto të ulëta operative vjetore.

c) Rritja e kapaciteteve administrative

Nevojiten:

- trajnime për AKEP;
- trajnime për bashkitë;
- trajnime për autoritetet që lëshojnë leje.

Vlerësim: Kosto e ulët.

Kostot për operatorët

Operatorët mund të përballen me:

- përshtatjen e proceseve administrative;
- raportimin e të dhënave për infrastrukturën;
- integrimin me sistemin SIP.

Megjithatë këto kosto janë kryesisht njëherëshe.

Vlerësim: Kosto e ulët deri mesatare.

Kostot e përputhshmërisë për subjektet e tjera

Subjektet që zotërojnë infrastrukturë fizike (energji, ujësjellës, transport etj.) mund të kenë nevojë të:

- regjistrujnë asetet;
- shkëmbejnë informacion;
- bashkëpunojnë në koordinimin e punimeve.

Vlerësim: Kosto e ulët administrative.

Përfitimet ekonomike

Reduktimi i kostove të vendosjes së rrjeteve

Komisioni Evropian ka vlerësuar se punimet civile përbëjnë deri në 70–80% të kostove totale të vendosjes së rrjeteve me fibra optike.

Transpozimi i GIA:

- mundëson ripërdorimin e infrastrukturës ekzistuese;
- redukton gërmimet e përsëritura;
- rrit koordinimin ndërmjet operatorëve.

Për Shqipërinë pritet:

- ulje e kostove të investimit në rrjetet me fibra optike;
- përmirësim i fizibilitetit ekonomik të investimeve në zonat rurale.

Përfitimi: Shumë i lartë.

Rritja e investimeve private

Siguria rregullatore dhe procedurat më të shpejta:

- ulin rrezikun e investimeve;
- përmirësojnë kthimin e investimit (ROI);
- nxisin investime të reja nga operatorët.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme për:

- FTTH/B;
- rrjetet 5G;
- backhaul me fibra optike.

Përfitimi: I lartë.

Rritja e konkurrencës

Lehtësimi i aksesit në infrastrukturë:

- ul barrierat e hyrjes në treg;
- krijon mundësi për operatorë të rinj;
- nxit përdorimin më efikas të asetëve ekzistuese.

Përfitimi: Mesatar deri i lartë.

Përfitimet sociale

Përmirësimi i aksesit në internet me shpejtësi të lartë

Transpozimi i GIA do të përshpejtojë:

- mbulimin me fibra optike;
- mbulimin me 5G;
- lidhjen e institucioneve publike.

Përfituesit kryesorë:

- qytetarët;
- bizneset;
- shkollat;
- universitetet;
- spitalet.

Përfitimi: Shumë i lartë.

Ulja e hendekut digjital

Investimet bëhen më të realizueshme ekonomikisht edhe në:

- zonat rurale;
- zonat malore;
- komunitetet e largëta.

Kjo ndihmon në:

- përfshirjen sociale;
- zhvillimin rajonal;
- barazinë e aksesit.

Përfitimi: I lartë.

Përmirësimi i shërbimeve publike

Lidhja gigabit mbështet:

- e-Albania;
- telemjekësinë;
- arsimin online;
- shërbimet cloud të administratës.

Përfitimi: I lartë.

Përfitimet makroekonomike

Rritja e produktivitetit

Rrjetet gigabit:

- reduktojnë kostot operative të bizneseve;
- rrisin efikasitetin;
- mundësojnë automatizim dhe inovacion.

Kjo ndikon pozitivisht në:

- TIK;
- financa;
- tregti;
- turizëm;
- industri.

Përfitimi: Shumë i lartë.

Mbështetja e transformimit digjital

Ligji i ri (GIA) krijon bazën infrastrukturore për:

- Inteligjencën Artificiale (AI);
- Internet of Things (IoT);
- Smart Cities;
- Cloud Computing;
- Data Economy.

Përfitimi: Shumë i lartë.

Tërheqja e investimeve të huaja

Disponueshmëria e lidhjeve gigabit konsiderohet faktor kyç për:

- qendrat e të dhënave;
- kompanitë teknologjike;
- BPO dhe outsourcing;
- investitorët ndërkombëtarë.

Përfitimi: I lartë.

Përfitimet institucionale dhe të integrimit evropian

Transpozimi i GIA:

- harmonizon legjislacionin shqiptar me acquis të BE-së;
- mbështet negociatat e anëtarësimit;
- përmirëson kapacitetet rregullatore të AKEP;
- rrit transparencën dhe parashikueshmërinë rregullatore.

Përfitimi: Shumë i lartë.

Vlerësimi i përgjithshëm

Kategoria	Kostot	Përfitimet
Administrata publike	Mesatare	Shumë të larta
Operatorët	Të ulëta–mesatare	Shumë të larta
Bizneset	Të ulëta	Të larta
Qytetarët	Minimal	Shumë të larta
Ekonomia kombëtare	Minimal	Shumë të larta
Integrimi në BE	Minimal	Shumë të larta

Përfundim

Analiza tregon se kostot e transpozimit dhe zbatimit të GIA janë kryesisht afatshkurtra, të kufizuara dhe të menaxhueshme, ndërsa përfitimet ekonomike, sociale, teknologjike dhe institucionale janë të konsiderueshme dhe afatgjata. Reduktimi i kostove të vendosjes së rrjeteve gigabit, rritja e investimeve private, përmirësimi i konkurrencës, zgjerimi i mbulimit me fibra optike dhe 5G, si dhe harmonizimi me acquis-in e Bashkimit Evropian tejkalojnë ndjeshëm kostot e zbatimit. Për këtë arsye, transpozimi i GIA konsiderohet opsioni me raportin më të favorshëm kosto–përfitim dhe alternativa e rekomanduar për arritjen e objektivave kombëtare të lidhjes gigabit dhe transformimit digjital të Shqipërisë.

Sipas **analizës me shumë kritere (Multi-Criteria Analysis)**, Opsioni 2 vlerësohet më lart për shkak të përputhjes së plotë me acquis të BE-së, ndikimit të fortë pozitiv social (reduktim i hendekut digjital dhe rritje e aksesit në shërbime dixhitale), si dhe përmirësimit të konkurrencës në treg. Ai balancon në mënyrë optimale kriteret e kostos, efektivitetit, qëndrueshmërisë dhe realizueshmërisë institucionale.

Në përfundim, Opsioni 2 përfaqëson zgjidhjen më të mirë strategjike dhe ekonomike për Shqipërinë, duke garantuar një implementim të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt rezultateve të Gigabit Infrastructure Act.

Analiza me shumë kritere

Opsionet që merren në konsideratë janë:

Opsioni 0 – status *quo*-ja.

Opsioni 1 – Kryerja e ndërhyrjeve ligjore,

Opsioni 2 – Miratimi i një ligji të ri do të plotësonte kuadrin ligjor aktual dhe do adresonte problematikat ekzistuese.

Opsioni 3 – Jo rregullator

Kriteret për vlerësimin e opsioneve dhe pesha e secilit sipas rëndësisë relative:

Shkalla e vlerësimit: 1 = shumë i dobët, 5 = shumë i lartë

Tabela e vlerësimit

Kriteri	Pesha (%)	Opsioni 0 (Status quo)	Opsioni 1 (Ndërhyrje minimale)	Opsioni 2 (GIA i plotë)	Opsioni 3 Jo-rregullator
Efektiviteti në arritjen e objektivave. Adresimi i problematikave ekzistuese	30	1(0.3)	3(0.9)	5(1.5)	1(0.3)
Ndikimi ekonomik (kosto–përfitim)	20	2(0.4)	3(0.6)	5(1.0)	2(0.4)
Efikasiteti administrative dhe procedurat e lejeve	10	2(0.2)	2(0.2)	5(0.5)	1(0.1)
Qëndrueshmëria institucionale	15	2(0.3)	3(0.45)	4 (0.6)	1(0.15)

Harmonizimi me acquis të BE-së	25	1(0.25)	1(0.25)	5(1.25)	1(0.25)
Rezultati Total i Ponderuar	100	1.45	2.40	4.85	1.2

Shkalla e performancës është nga 0 në 5, ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

Rezultati i ponderuar (përmbledhje)

Opsioni	Pikë totale e ponderuar (maks 5)	Vlerësimi final
Opsioni 0	1.45	Jo i pranueshëm
Opsioni 1	2.40	I kufizuar
Opsioni 2	4.85	Opsioni i preferuar
Opsioni 3	1.2	Jo i pranueshëm

Analiza e rezultateve

Opsioni 0 – Status Quo-ja

Ky opsion nënkupton ruajtjen e kuadrit aktual ligjor pa ndërhyrje të reja. Edhe pse nuk krijon kosto shtesë administrative, ai nuk adreson problematikat kryesore të identifikuarra dhe nuk siguron harmonizimin me kërkesat e GIA. Për këtë arsye, ky opsion rezulton me performancën më të ulët.

Opsioni 1 – Kryerja e ndërhyrjeve ligjore në kuadrin ekzistues

Ky opsion parashikon amendimin e dispozitave ekzistuese në ligjin për komunikimet elektronike dhe aktet nënligjore përkatëse. Ai sjell përmirësime të pjesshme, por nuk siguron një transpozim të plotë dhe koherent të GIA, duke lënë boshllëqe ligjore dhe institucionale.

Opsioni 2 – Miratimi i një ligji të ri për transpozimin e GIA

Ky opsion parashikon krijimin e një kuadri të dedikuar ligjor për zbatimin e kërkesave të GIA, duke përfshirë procedurat e harmonizuara të lejeve, koordinimin e punimeve civile, krijimin e Pikës së Vetme të Informacionit, aksesin në infrastrukturën fizike dhe masat për reduktimin e kostove të vendosjes së rrjeteve gigabit. Edhe pse kërkon investime fillestare dhe angazhim institucional më të madh, ai siguron përfitimet më të larta ekonomike, sociale dhe rregullatore, si dhe harmonizimin e plotë me acquis-in e Bashkimit Evropian.

Opsioni 3 –Jo-rregullator

Ky opsion mbështetet në masa vullnetare, udhëzime administrative dhe mekanizma bashkëpunimi pa vendosur detyrime të reja ligjore. Edhe pse ka kosto të ulëta, ai nuk garanton zbatimin e njëtrajtshëm të masave të nevojshme dhe nuk adreson në mënyrë efektive pengesat strukturore të tregut.

Bazuar në rezultatet e Analizës me Shumë Kritere, **Opsioni 2 – Miratimi i një ligji të ri për transpozimin e Gigabit Infrastructure Act (GIA)** rezulton alternativa më e përshtatshme, me rezultatin më të lartë të ponderuar (**4.85 nga 5.00**). Ky opsion siguron harmonizimin e plotë me acquis-in e Bashkimit Evropian, adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse problematikat e identifikuarra, krijon siguri juridike afatgjatë për investitorët dhe mundëson realizimin e objektivave kombëtare për zhvillimin e rrjeteve gigabit dhe transformimin digjital të Shqipërisë. Opsioni 2 siguron efektivitet të lartë, përfitim ekonomik maksimal dhe përputhshmëri të plotë me BE-në, pa rritur në mënyrë disproporcionale kostot publike

Cështje të zbatimit

1. *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
2. *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
3. *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

1. Struktura përgjegjëse për zbatimin

Zbatimi i opsionit të zgjedhur do të udhëhiqet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si ministria përgjegjëse për infrastrukturën digjitale, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetin rregullator të komunikimeve elektronike (AKEP). Bashkitë dhe institucionet menaxhuese të infrastrukturës publike do të kenë rol operacional në nivel lokal. Do të duhet të krijohet një strukturë ndërinstitucionale koordinuese për të siguruar harmonizimin e veprimeve. Kjo strukturë do të mbikëqyrë implementimin e një “one-stop-shop” dhe databaze kombëtare të infrastrukturës. Roli i saj kryesor është garantimi i zbatimit të plotë dhe të njëtrajtshëm të reformës.

2. Pengesat e mundshme për zbatimin

Pengesat kryesore për zbatimin lidhen me kapacitetet e kufizuara administrative dhe teknike në nivel qendror dhe lokal. Ekziston rreziku i mungesës së koordinimit ndërinstitucional dhe rezistencës nga disa aktorë të tregut. Vonesa në zhvillimin e sistemeve digjitale mund të ngadalësojë implementimin fillestar. Gjithashtu, mungesa e të dhënave të sakta për infrastrukturën ekzistuese përbën një sfidë të rëndësishme. Këto faktorë mund të ndikojnë në ritmin dhe efikasitetin e zbatimit të reformës.

3. Masat gjatë zbatimit

Gjatë zbatimit do të ndërmerren masa për forcimin e kapaciteteve institucionale përmes trajnimeve dhe asistencës teknike. Do të zhvillohet një platformë digjitale “one-stop-shop” për thjeshtimin e procedurave administrative. Do të vendosen afate të detyrueshme dhe standarde të unifikuara për lejet dhe koordinimin e punimeve civile. Bashkëpunimi ndërinstitucional do të formalizohet përmes protokolleve dhe grupit të përbashkët koordinues. Gjithashtu, do të sigurohet konsultim i vazhdueshëm me operatorët dhe palët e interesit.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

4. *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
5. *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

4. Faza e monitorimit dhe vlerësimit

Monitorimi dhe vlerësimi do të realizohen përmes raportimit periodik nga institucionet zbatuese dhe një sistemi të centralizuar të të dhënave. Do të kryhen vlerësime vjetore mbi progresin e reformës dhe efektet e saj në treg. Transparenca do të sigurohet përmes publikimit të rregullt të raporteve të performancës. Një strukturë e dedikuar do të analizojë përputhshmërinë me objektivat strategjike. Rezultatet do të përdoren për përmirësim të vazhdueshëm të politikës.

5. Kriteret/treguesit e matjes (KPI)

Progresi do të matet përmes indikatorëve kryesorë të performancës (KPI) si:

- Shkalla e penetrimit të broadbandit fikse bazuar në VHCN të rritet nga 4% në vitin 2026 në 30% në pesë vitet e para;
- Numri i lidhjeve fikse broadband VHCN të arrijë nga 29977 në 250000 brenda 5, viteve të para;

- Përqindja e mbulimit me rrjete të broadbandit celular të bazuar në VHCN në 85% në vitin 2030;
- Numri i përdoruesve mobile broadband (VHCN-së celulare) 5G të rritet me 50% në vitin 2030;
- Koha mesatare për Lejet e ndërtimi për stacionet bazë (Broadband dhe 5G) të reduktohet deri në 4 muaj;
- Koha mesatare për Lejet ndërtimi për instalimin nëntokësor të fibrave të reduktohet deri në 4 muaj;
- Numri i Autorizimeve për të drejtën e aksesit të infrastrukturës fizike ekzistuese
- Numri i Autorizimeve për të drejtën e kalimit
- Numri i Autorizimeve për infrastrukturën brenda ndërtesës
- Numri i Autorizimeve për qeliza të vogla (antena të vogla)

Synojmë që trendi për të gjithë këta indikatorë që lidhet me autorizimet të jetë në rritje, mbas miratimit të nismës për ligjin e ri.

Reduktimi i kostove të ndërtimit të rrjeteve do të jetë një indikator kyç ekonomik. Për më tepër, do të monitorohet përmirësimi i aksesit digjital në zonat rurale dhe urbane.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin - një herë										
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi										
Kosto për bizneset - një herë										
Kosto për bizneset - në vazhdimësi										
Kosto për grupet e tjera - një herë										
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi										
Kosto në total										
Kosto e zbritur = Kosto në total x Faktori zbritës										
Përfitimet për buxhetin – një herë										
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi										
Përfitimet për grupet e tjera – një herë										
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi										
Përfitimet për biznesin – një herë										

Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi										
Përfitimet totale										
Përfitimi i zbritur = Përfitimi në total x faktori zbritës										
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total										
Vlera prezente aktuale e kostos në total										
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	0	0	0